Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-172188
Më 12.12.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e fillimit të procedurave ligjore për procedimin e projekteve me Partneritet Publiko-Privat për tregjet, dhe mori këtë

KONKLUZION

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e fillimit (zhvillimit) të procedurave ligjore për procedimin e projekteve me Partneritet Publiko-Privat për tregjet në lagjen "Bajram Curr" dhe tregun "Qylhan", kështu që, për këtë qëllim dhe duke u bazuar në Ligjin për Partneritet Publiko-Privat nr. 04/L-045, lejohet fillimi i procedurave përkatëse.

II. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike.

III. Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Shërbimeve Publike, Organet Kompetente sipas ligjit, si dhe Arkivi.

IV. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-176374
Më 12.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës më 12 dhjetor 2014, miratoi këtë:

# A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Ekipi për menaxhimin e projekteve me Partneritet Publiko -Privat për tregjet në lagjen "Bajram Curr" dhe tregun "Qylhan".

Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

a. Fejsal Hoti, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike,
b. Hatixhe Përzhella, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike,
c. Isa Osmankaj, nga Sektori i Prokurimit,
d. Gursel Skenderi, nga Sektori i Pronës, dhe
e. Afërdita Mormorina, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin për Partneritet Publiko-Privat nr. 04/L-045.

III. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi

IV. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, si dhe të emëruarit.

V. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, të emëruarit, Organet Kompetente sipas ligjit, dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja.

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-172188
Më 12.12.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me dhurata për Vitin e Ri 2015, dhe mori këtë

## KONKLUZION

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e furnizimit me dhurata për Vitin e Ri 2015, për punëtorët e Komunës së Prizrenit, për familjet e dëshmorëve, familjet strehuese dhe për fëmijët me nevoja të veçanta në tërë territorin e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

II. Nga buxheti i Komunës –pozicioni i subvencioneve të Zyrës së kryetarit të Komunës së Prizrenit, për këtë qëllim (furnizim me dhuratave), lejohen mjetet financiare deri në shumën 1500 €, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve financiare do të mbulohet nga drejtorit tjera përkatëse.

III. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, NjDNj, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

IV. Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, NjDNj, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

V. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-176381
Më 12.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 8 pacientëve, kryetari i Komunës më 12 dhjetor 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 2.12.2014, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Ganimete Sallauka, 2. Sadete Jahaj, 3. Ahmet Klisurica, 4. Myvedet Memishi, 5. Fejka Ramani, 6. Sadik Bilibani, 7. Leart Shehu, dhe 8. Zenun Kryeziu. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-172188
Më 12.12.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me dy kompjuter, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e furnizim me dy (2) kompjuter për nevojat e Sektorit të Pyjeve në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-176390
Më 12.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projektit: "Turizmi në Komunën e Prizrenit", kryetari i Komunës më 12 dhjetor 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projektit: "Turizmi në Komunën e Prizrenit", i cili projekt do të realizohet nga Radio Prizreni përmes emisioneve në radio. Kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të pagesës së këtij projekti, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 3060 €.

II. Në kuadër të këtij projekti, Radio Prizreni do të realizoj 24 emisione për një periudhë gjashtë (6) mujore.

III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Radio Prizreni, si dhe Arkivi.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-172188
Më 12.12.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit të Sallës Koncertale dhe për riparimin e dhomave për mësim në ndërtesën e ish shkollës së Muzikës, dhe mori këtë

## KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e hartimit të projektit të Sallës Koncertale dhe për riparimin e dhomave për mësim në ndërtesën e ish shkollës së Muzikës, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-176392
Më 12.12.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", kryetari i Komunës, më 12 dhjetor 2014, miratoi këtë:

VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 2.12.2014, për përkrahje financiare për KF "Liria", me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për nevojat e klubit, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 9000 €.

II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KF "Liria", si dhe arkivi.

V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja